



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

Lënda: Lajmi në median audiovizive

<i>Pedagogu:</i>	Mentor Kikia / Ma. Anisa Ymeri (Doktorante)
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (15 javë: 1 leksion dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	Me detyrim
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Lënda ‘Lajmi në mediat audiovizive’ njeh studentët me veçantësitë e lajmit televiziv dhe synon t'i qasë e përballë me terrenin, për të nisur që në auditor të jenë reporterë. Kjo përvijohet gradualisht e paralelisht me marrjen e leksioneve teorike në auditor dhe orët praktike të lëndës (seminaret), që janë parë si thelbësore për përfitimin maksimal të studentëve nga ky kurs. Gjatë semestrit dalin në terren për mbulimin e ngjarjeve të cilat përherë janë të lidhura me temat e leksioneve, etj

Temat e leksioneve:

1. Raportimi dhe shkrimi i lajmit në mediat audiovizive, ndryshimet nga lajmi për shtyp. Rregullat e gjetjes, raportimit dhe shkrimit të lajmit për audiovizualin dhe ndryshimet thelbësore që ka me lajmin për shtyp.
2. Objektiviteti dhe vërtetësia e lajmit. Parime, teori bazë dhe përballja me realitetin mediatik në Shqipëri.
3. Burimet e lajmit dhe përdorimi i tyre. Shembuj nga gazetaria e huaj dhe sidomos ajo shqiptare. Çelësi i suksesit të një reporteri dhe ndërtimi i karrierës së tij janë burimet.
4. Gërmimi i informacionit; a) Hulumtimi, b) Interpretimi i fakteve, c) Vëzhgimi mbi ngjarjet, c) Follow-Up i lajmeve në televizion.
5. Mbulimi i sektorëve- Ndarja e tyre dhe ndërtimi e funksionimi i redaksisë; si funksionon një News Room. Mediat e mëdha funksionojnë mirë në sajë të ndarjes së sektorëve dhe specializimit të reporterëve në sektorë të caktuar, çka dikton edhe mënyrën e funksionimit të një News Room-i, prej të cilit varet edhe cilësia e gjithçkaje shfaqet në ekran e përcillet për audiencën.
6. Kronika e zezë (lajmet e aktualitetit). a) Policia; b) Gjykata; c) Prokuroria.
7. Lajmi social. Përcjellja e problematikave sociale kanë (apo duhet të kenë) peshë të rëndësishme në media, ndaj edhe mbulimi i problematikave të qytetit apo me gjerë se kaq, marrin jo pak hapësirë në redaksi. a) Mbulimi i problematikave të qytetit; b) Mjedisi; c) Problematika shoqërore.
8. Lajmi ekonomik. Lajmet nga ekonomia janë edhe më specifike dhe në media janë në minorancë të tilla kronika për shkak të mungesës së gazetarisë mirëfilli ekonomike në Shqipëri. Shpesh gazetaria ekonomike përkthehet në ‘sondazhe se çfarë ndodh me çmimet në tregje’. Realiteti shqiptar dhe ai botëror.
9. Lajmi politik. Vështrim kritik mbi situatën e medias në vend sa i takon mbulimit të lajmieve politike. a) Konferencat e shtypit; b) Kuvendi; c) Mitingjet; d) Tryezat e rumbullakta.
10. Investigimi. Gazetaria e munguar investigative në Shqipëri është jo pak e përfolur. Cili është realiteti ynë? Çfarë e pengon gazetarinë investigative? Çfarë ka ndodhur me programet investigative në media të mëdha?
11. Entertainment – a) Kulturë; b) Zbavitje; c) Soft News; d) Sporte.

12. Redaktimi i lajmeve në televizion; a)Roli i kryeredaktorit dhe redaktorit; b)Qëndrimi redaksional/editorial; b) Renditja e lajmeve në edicionin informativ; c) Struktura e edicioneve informative.
13. Struktura multimediale e disa kompanive mediatike në Shqipëri. Rrjeti nga ku kalon informacioni që publikohet e transmetohet minutë pas minute.
14. Lajmet nga Rajoni dhe Bota.
15. Intervistat televizive – Përgatitja, formulimi i pyetjeve, krijimi i raportit, siguri dhe saktësi, transmetimi.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në:70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II:në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra – lajme të raportuara dhe të shkruara për dorëzim	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. RAPORTIMI DHE SHKRIMI I LAJMEVE (MISSOURI GROUP), BOTIMET IDK, 2011. BRIAN S. BROOKS, GEORGE KENNEDY, DARYL R. MOEN, DON RANLY.
2. GAZETARIA TELEVIZIVE, ALEX BUCHHOLZ, GERHARD SCHULT, BOTIMET K & B, PËRKTHEU:A. KLOSI.
3. RAPORTIMI DHE SHKRIMI I LAJMEVE, MELVIN MENSHER (COLUMBIA UNIVERSITY), BOTIMI I PESTË, ONUFRI. SHQIPËROI: ARBEN KALLAMATA.GAZETARIA, STEPHAN RUSS-MHOL, K & B 2011, SHQIPËRUAR NGA ARDIAN KLOSI

Literatura plotësuese:

1. Gazetaria Investigative, përmbledhje artikujsh- Instituti Shqiptar i Medias
2. Gazetaria 2.0: Të merresh me informacionin në kohën e internetit ; Riçardo Stagliano- ISHM.
3. Televizioni në Europë : rregullimi, politikat dhe pavarësia- ISHM
4. Mediat online në Shqipëri, Rrapo Zguri-ISHM.
5. Writing and reporting news (A choacing method), Carole Rich.
6. Writing for Mas Media (Sixth edition, Eng), James Glen Stovall (Version elektronik)